



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 3367 Prot.

Tiranë më 30.01.2023

3

VENDIM

Nr. 3, datë 30.01 2023

“Për saktësimin e emërimit të programit të studimit Master i Shkencave në “Trajtimi Automatik i Gjuhëve”, të Fakultetit të Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës”

Bazuar në ligjin Nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” neni 3, pika 2, gërma b; neni 38, pika 1, gërma dh; Udhëzimin e MASR-së Nr. 1, datë 14.01.2020 “Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e IAL, degëve të tyre, njërive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e IAL”, i ndryshuar, Kreu IV, Udhëzimin e MASR-së nr. 10, datë 30.03.2020 “Për përcaktimin e elementëve përbërës, formën e diplomës ose certifikatës të lëshuar nga institucionet e arsimit të lartë dhe procedurës së regjistrimit të tyre në regjistrin shtetëror të diplomave dhe certifikatave për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor”, i ndryshuar; Kreu I, pika 2, në Statutin e Universitetit të Tiranës neni 31, gërmat f dhe cc; si dhe në propozimin e Fakultetit të Gjuhëve të Huaja me shkresën Nr. 2024/4 Prot., datë 07.12.2022, Senati Akademik i Universitetit të Tiranës në mbledhjen e datës 30.01.2023;

VENDOSI:

1. Të miratojë propozimin e Fakultetit të Gjuhëve të Huaja për saktësimin e emërimit të programit të studimit nga Master i Shkencave në “Trajtimi Automatik i Gjuhëve” në:

Master i Shkencave në “Trajtimi Automatik i Gjuhëve” në drejtimin “Trajtimi Informatik dhe Gjuhësor i Dokumenteve të Shkruara”.

2. Ky vendim i përcillet për procedura të mëtejshme Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
PROF. DR. ARTAN HOXHA

